



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

**UDHËZUES**



**PËR  
PROCEDURAT E APLIKIMIT, SHQYRTIMIT,  
VLERËSIMIT, MIRATIMIT DHE MONITORIMIT TË  
PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT  
SHKENCOR (PIKSH)**

**Viti 2024**

# PËRMBAJTJA

<b>KREU I .....</b>	<b>3</b>
<b>PROCEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT FORMAL TË PROJEKTEVE.....</b>	<b>3</b>
1.1. Rreth Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor .....	3
1.2. Qëllimi i PIKSH.....	3
1.3. Synimi i PIKSH .....	3
1.4. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve.....	3
<b>KREU 2 .....</b>	<b>4</b>
<b>PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE.....</b>	<b>4</b>
2.1 Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte .....	4
2.2 Dokumentacioni i aplikimit .....	4
2.3 Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit .....	4
2.4 Shqyrtimi i dosjes së aplikimit.....	5
2.5 Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit .....	5
2.6 Njoftimi i fituesve .....	5
<b>KREU 3.....</b>	<b>5</b>
<b>VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE.....</b>	<b>5</b>
3.1. Qëllimi i vlerësimit dhe miratimit të projekteve .....	5
3.2. Procesi i vlerësimit.....	5
3.3. Procedura e miratimit për financim të projekteve.....	6
<b>KREU 4.....</b>	<b>6</b>
<b>ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBIZBATIMIN E TYRE .....</b>	<b>6</b>
4.1. Financimi i projekteve fituese .....	6
4.2. Buxheti i detajuar .....	7
4.3. Raportimi .....	7
4.4. Raporti përfundimtar .....	7
<b>KREU 5.....</b>	<b>8</b>
<b>MONITORIMI I PROJEKTEVE.....</b>	<b>8</b>
5.1. Qëllimi i monitorimit .....	8
5.2. Fazat e monitorimit .....	8
5.3. Detyrimet e përfituesit .....	8
5.4. Raportet e monitorimit AKKSHI.....	9
<b>KREU 6.....</b>	<b>9</b>
<b>KONFLIKTI I INTERESTIT DHE KONFIDENCIALITETI .....</b>	<b>9</b>
ANEKS 2/1 .....	9
ANEKS 3 .....	11

# **KREU I**

## **PROÇEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT FORMAL TË PROJEKTEVE**

### **1.1. Rreth Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor**

Infrastrukturat e Kërkimit Shkencor ofrojnë burime dhe shërbime për komunitetet kërkimore për të kryer kërkime dhe për të nxitur inovacionin. Ato përfshijnë:

- pajisje kryesore shkencore ose grupe instrumentesh të kërkimit;
- koleksione, arkiva ose të dhëna shkencore;
- sisteme informatike dhe rrjete të komunikimit;
- çdo infrastrukturë tjetër kërkimore dhe inovative e një natyre unike e cila është e hapur për përdoruesit e jashtëm<sup>1</sup>.

Rritja e kapaciteteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) është një nga objektivat kryesorë strategjikë në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri dhe në një linjë me parimet e Zonës Europiane të Kërkimit Shkencor (ERA) dhe të perspektivës së antarësimit të vendit në Bashkimin Europian (BE).

Programi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor filloi të zbatohet në vitin 2019 në kuadër të Paktit për Universitetin, nëpërmjet financimit nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) të projekteve të infrastrukturës kërkimore shkencore të IAL-ve. Ky program synon zbatimin e suksesshëm të politikave në këtë fushë, duke kontribuar në standartizimin e sistemit institucional të Kërkimit Shkencor (KSH) dhe në orientimin e kërkimit shkencor drejt një ekonomie konkurruese dhe inovative.

### **1.2. Qëllimi i PIKSH**

Projektet e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) mbështesin kërkimin shkencor dhe inovacionin sipas prioriteteve kombëtare të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale në shërbim të IAL-ve publike dhe komunitetit shkencor, duke e vënë punën kërkimore-shkencore në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.

### **1.3. Synimi i PIKSH**

Synimi i PIKSH është përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor nëpërmjet financimit të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor bazuar në fushat prioritare kombëtare dhe në përputhje me zhvillimet rajonale dhe europiane të kërkimit shkencor.

### **1.4. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve**

---

<sup>1</sup> Burimi i referencës: [https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/european-research-infrastructures\\_en](https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/european-research-infrastructures_en)

Të drejtën për të aplikuar me projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, në fushat prioritare të miratuara, e kanë institucionet e arsimit të lartë publik<sup>2</sup> që, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, zhvillojnë kërkim shkencor.

## **KREU 2**

### **PROÇEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE**

#### **2.1 Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte**

Bordi i Administrimit (BA) i AKKSHI-së miraton hapjen e thirrjes për aplikim me projekte të Infrastrukturës së kërkimit shkencor. Vendimi i BA publikohet në faqen zyrtare web të AKKSHI dhe është i aksesueshëm për gjithë të interesuarit.

#### **2.2 Dokumentacioni i aplikimit**

Dokumentacioni për aplikim për projekte hartohet nga AKKSHI dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare web të institucionit për të gjithë institucionet që janë të interesuar dhe kanë të drejtën të aplikojnë për projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor.

Aplikantët paraqesin kërkesën për financim në kuadrin e PIKSH në formën e një projekt propozimi shoqëruar edhe me shkresë zyrtare përcjellëse nga institucioni që aplikon. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në AKKSHI nëpërmjet protokollit në 2 (dy) kopje, dhe në formë elektronike.

Projekt-propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formatit të Aplikimit të projekt propozimit për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor (*Aneks 1*) dhe Formularit të Buxhetit (*Aneks 2*). Sqarimet për plotësimin e Dokumentit të Projektit për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor dhe të Formularit të Buxhetit gjenden në *Aneks 2/1* si dhe dokumentat e listuara në *Aneks 3*.

#### **2.3 Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit**

Dosja e aplikimit me projektpropozimin, duhet të depozitohet në AKKSHI brenda afatit të përcaktuar në Thirrjen për aplikim të shpallur nga AKKSHI.

Përcaktimi i afateve për depozitimin e aplikimit kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”. Llogaritja e afateve të depozitimit të dosjes së aplikimit pranë AKKSHI, kryhet në përputhje me përcaktimet e neneve 56 dhe 57 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.

---

<sup>2</sup> VKM Nr. 75, datë 12.08.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”

Aplikuesi mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, në përputhje me nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.

## **2.4 Shqyrtimi i dosjes së aplikimit**

Në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kontrolli formal bëhet nga Drejtoria e Programeve Kombëtare, në Sektorin e Teknologjisë dhe Inovacionit, që administron Projektpropozimet për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor. Ai synon të vlerësojë nëse projektpropozimi është formuluar në përputhje me Modelin e Formatit të Aplikimit të Projektpropozimit (Aneks 1).

## **2.5 Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit**

Projektpropozimet të cilat i janë përmbajtur kritereve administrative të vendosura nga AKKSHI së bashku me dokumentacionin përkatës, kalojnë në procesin e vlerësimit teknik nga komisionet e vlerësimit të projekteve.

## **2.6 Njoftimi i fituesve**

Pasi vlerësohen nga komisionet e ekspertëve të vlerësimit dhe pasi miratohen nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, projektet të cilat shpallen fituese njoftohen me shkresë zyrtare dhe gjithashtu shpallja e fituesve bëhet edhe në faqen zyrtare të internetit të AKKSHI.

# **KREU 3**

## **VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE**

### **3.1. Qëllimi i vlerësimit dhe miratimit të projekteve**

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të drejtimit të çdo aktiviteti shkencor. Atij i nënshtrohen të gjitha projektet për Bashkëpunim IAL-Biznes.

Ai nevojitet për të evidentuar gjendjen reale të ecurisë së projekteve dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e saj, për të nxjerrë përfundime të drejta lidhur me vlerën e vetë projekteve, rezultatit shkencor të projektit, problemet administrative, financiare si dhe mësimet në lidhje me projektet e ardhshme. Ai synon të vlerësojë nëse projekt propozimi është formuluar në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit për të gjitha fushat prioritare.

### **3.2. Procesi i vlerësimit**

Procesi i vlerësimit fillon me kontrollin teknik formal e administrativ që kryhet nga stafi i Drejtorisë së Programeve Kombëtare në AKKSHI dhe synon përmbushjen e kriterëve të aplikimit dhe të dokumentacionit që aplikantët kanë paraqitur.

Projekt propozimet që kalojnë fazën e parë i përcillen për ekspertizë Komisionit të Ekspertëve, që bën vlerësimin përmbajtësor e shkencor të tyre.

Komisioni i ekspertëve për kryerjen e vlerësimit përmbajtësor e teknik të projekt propozimeve, miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-t pas një procesi të hapur aplikimesh nga kandidatët. Anëtarët e tij zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse dhe nuk janë pjesë e personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë.

Procesi i vlerësimit bëhet në përputhje me Skedën e Vlerësimit të Projekteve. (Aneks 3)

Komisioni i Ekspertëve përpara fillimit të procesit të vlerësimit, nënshkruan Deklaratën e Konfliktit të Interesit (Aneks 4) dhe të paanshmërisë dhe integritetit profesional.

Eksperti i vlerësimit shpërblehet për punën e kryer bazuar në VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”. Në grupin e vlerësimit nuk përfshihen persona të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në aktet e hartimit, miratimit, zbatimit dhe drejtimit të projektit.

### **3.3. Procedura e miratimit për financim të projekteve**

Procesi i miratimit për financim të projektit kalon përmes këtyre hapave:

- a) Vlerësimet e Komisionit të Ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t me procesverbalin përkatës të mbajtur nga çdo komision dhe listën rankuese të firmosur nga ekspertët vlerësues. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI përcjell listën e sipërpërmendur për përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve fituese në Bordin e Administrimit.
- b) Për projekt-propozimet që janë miratuar për financim nga Bordi i Administrimit, lidhet kontrata sipas modelit bashkëlidhur ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI dhe IAL-së që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga drejtuesi i tij dhe drejtuesi i projektit.

## **KREU 4**

### **ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E TYRE**

#### **4.1. Financimi i projekteve fituese**

- a) Pas vlerësimit nga ekspertët e Komisioneve të vlerësimit, miratimit të projekteve fituese në Bordin e Administrimit dhe lidhjes së kontratës, përfituesi do të marrë fondin e përcaktuar, brenda një afati jo më të gjatë se 45 ditë pas shpalljes së vendimit për financimin e projektit.

- b) Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga Bordi i AKKSHI-së. Kërkesa duhet të dërgohet të paktën 15 (ditë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së. AKKSHI-ja njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë së përfituesit.
- c) Kërkesa për shtyrje të afatit të përfundimit të projektit dhe të dorëzimit të raportit përfundimtar miratohet nga AKKSHI pas shqyrtimit të argumentave të parashtruara nga kërkuesi.
- d) Kërkesa duhet të dërgohet të paktën 15 (ditë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së.
- e) Ndryshimet në zërat buxhetore lejohen deri në një total prej 10 % të fondit të financuar nga AKKSHI-ja, vetëm brenda të njëjtit zë dhe mund të bëhen vetëm me miratimin paraprak të AKKSHI. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKKSHI-në duke argumentuar që ndryshimet e kërkuara nuk ndikojnë në cilësinë e realizimit të projektit dhe janë propozuar në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.
- f) Përfituesi i grantit ka të gjithë përgjegjësinë ligjore lidhur me zbatimin e projektit sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe përcaktimeve të këtij udhëzimi.

## **4.2. Buxheti i detajuar**

Pas miratimit për financim nga BA, drejtuesi i projektit risjell Planin e Financimit të detajuar të projektit sipas Aneksit 2. Të gjitha shpenzimet e planifikuara duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit.

## **4.3. Raportimi**

- a) Për projektet dorëzohet raport i ndërmjetëm në gjysmën e parë të vitit të zbatimit të projektit, i cili duhet të depozitohet në AKKSHI me shkresë përcjellëse të titullarit të institucionit përfitues. Raporti duhet të pasqyrojë realizimin e aktiviteteve dhe të shpenzimeve të planifikuara. Mënyra e paraqitjes së raportimit duhet të jetë sipas formatit të AKKSHI.
- b) Përfituesi raporton për ecurinë e projektit sa herë dhe në mënyrën që i kërkohet nga AKKSHI.
- c) Në përfundim të realizimit të projektit, përfituesit dorëzojnë raportin përfundimtar.

## **4.4. Raporti përfundimtar**

Raporti final bëhet për cdo projekt më vete dhe i paraqitet organit financues në përfundim të projektit. Raporti final përfshin, raportin përshkrues, raportin financiar, dhe fotografi, video të realizimit të projektit. Në raport përshkruhet realizimi i detyrave dhe rezultatet e arritura, të shprehura me tregues sasiorë dhe cilësorë, detyrat e parashikuara që nuk janë realizuar dhe probleme që mund të jenë hasur dhe realizimi i planit të financimit sipas modelit të Aneks 9. Raporti final duhet të depozitohet në AKKSHI me shkresë përcjellëse.

## **KREU 5**

### **MONITORIMI I PROJEKTEVE**

#### **5.1. Qëllimi i monitorimit**

- a. Procesi i monitorimit fokusohet në dy drejtime kryesore:
  - i. në verifikimin e zbatimit të projektit sipas planit të miratuar për financim;
  - ii. në shqyrtimin e raporteve të drejtuesve të projekteve mbi ecurinë e projekteve.
- b. AKKSHI nuk ka funksion të saj auditimit financiar të fondeve që ka përfituar institucioni i arsimit të lartë nga granti përkatës apo të procedurave prokuruese.

#### **5.2. Fazat e monitorimit**

- a) Monitorimi i projekteve gjatë zbatimit të tyre realizohet nga AKKSHI mbi bazë kërkesë dhe sipas nevojës.
- b) Nëse e shih të arsyeshme, AKKSHI kryen edhe monitorim fizik përmes vizitës në institucionin përfitues.
- c) Monitorimi përfundimtar realizohet nga AKKSHI pasi përfituesi ka dorëzuar raportin përfundimtar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim.
- d) Në rastin kur, pas shqyrtimit të raportit përfundimtar, rezultojnë pasaktësi apo mungesë dokumentacioni, AKKSHI njofton me shkresë zyrtare përfituesin me kërkesën për plotësim.
- e) Përfituesi përcjell në AKKSHI raportin përfundimtar (së bashku me dokumentacionin plotësues) të rishikuar jo më vonë se 10 ditë pune nga marrja e kërkesës.
- f) Institucioni i arsimit të lartë përfitues i grantit mban përgjegjësi të plotë lidhur me ndjekjen e procesit dhe të procedurave të realizimit të projektit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe për raportimin në kohë dhe sipas kërkesave të AKKSHI.

#### **5.3. Detyrimet e përfituesit**

Në procesin e monitorimit përfituesi ka detyrim:

- a) të mundësojë aksesin në institucion për ekspertët e AKKSHI për monitorim fizik pas kërkesës dhe njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
- b) të japë informacion periodik mbi realizimin e projektit sa herë dhe në mënyrën që i kërkohet nga AKKSHI;
- c) të hartojë raportin (periodik dhe përfundimtar) në afat dhe përputhje me modelin, kërkesat, dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga AKKSHI.



#### 5.4. Raportet e monitorimit AKKSHI

Pas përfundimit të procesit të monitorimit, AKKSHI harton raportin përmbledhës me konstatimet dhe gjetjet përkatëse për çdo projekt të financuar.

## KREU 6 KONFLIKTI I INTERESTIT DHE KONFIDENCIALITETI

### Konflikti i interesit dhe konfidencialiteti

Si pjesë e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, AKKSHI do të ndajë përmbajtjen e aplikimeve për grante me ekspertë të brendshëm dhe/ose të jashtëm për të vlerësuar meritat e secilit aplikant dhe respektimin e kërkesave të përshkruara në këtë program. AKKSHI do të përpiqet të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë në një aplikim, por *aplikanti është përgjegjës për identifikimin specifik të të gjitha informacioneve konfidenciale brenda aplikimit për të cilat ai gjykon që nuk duhet të ndahen me të tjerë*. Nëse gjykohet e nevojshme nga paneli shqyrtues, aplikantëve mund t'u kërkohej të dorëzojnë informacione ose dokumentacion shtesë dhe/ose të paraqesin propozimin e tyre dhe informacione të tjera relevante të shqyrtuesit përpara se të merret një vendim për financimin. Në çdo rast, aplikuesit, vlerësuesit dhe stafi teknik zbaton parimet ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

### ANEKS 2/1

#### Sqarime për plotësimin e Dokumentit të Projektit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor dhe Formularit të Buxhetit

Plotësimi i saktë i Formularit të Aplikimit të projekt - propozimit të Infrastrukturës së KSH sipas kërkesave të Modelit të dhënë ka rëndësi të veçantë, sepse mbi këtë dokument bazohet zgjedhja ose refuzimi i projekt-propozimit për financim. Në plotësimin e tij të mbahet parasysh sa vijon:

- Në krye të Dokumentit shënohet emri i IAL-së aplikuese. (IAL që aplikon që njihet si person juridik dhe që merr përsipër të gjitha detyrimet për realizimin në kohë e me cilësi të

projektit.)

- Njësia bazë që bën propozimin (departamenti, sektori, fakulteti apo qendra shkencore) që do të realizojë apo do të drejtojë projektin;
- Shënohen të gjitha institucionet që do të bashkëpunojnë për realizimin e projektit, me të cilët IAL-ja ka nënshkruar marrëveshje, para paraqitjes së projekt-propozimit.
- Vazhdohet me titullin e projektit i cili duhet të jetë në shqip dhe anglisht.
- Plotësoni Fushën e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, të përcaktuar me Vendimin nr. 2 datë 11.05.2018 të Bordit të Administrimit të AKKSHI, si më poshtë:
  1. Bujqësi, Ushqim dhe Bioteknologji,
  2. Biodiversitet dhe Mjedis,
  3. Uji dhe Energjia,
  4. Shkenca Sociale dhe Albanologjike,
  5. Shëndetësi dhe Shkencat mjekësore,
  6. Sisteme dhe Teknologji Informacioni.
- Shënohet emëri i drejtuesit të projektit;
- Jepet *afati* i realizimit të projektit, duke shënuar kohën e fillimit (muaji, viti) dhe të përfundimit të tij (muaji, viti). Koha e përfundimit përfshin paraqitjen e raportit përfundimtar në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
- Plotësohet vlera totale e projektit në Lekë
- Vlera në Lekë (jo në monedhë tjetër) e shumës së kërkuar nga AKKSHI përfshirë në të vlerën e TVSH-së. Më pas vlera në lekë e buxhetit të siguar nga burime të tjera si dhe
- Vijohet me plotësimin e të dhënave të personave që do të marrin pjesë në realizimin e projektit.
- Jepen qëllimi dhe objektivat e projektit. Ato duhet të jenë të shprehura në mënyrë konçize dhe të saktë, duke vënë në dukje progresin që do të arrihet në krahasim me gjendjen para projektit. Duhet të mënjanojnë objektivat me karakter të përgjithshëm, ato duhet të jenë konkrete. Arritja e tyre duhet të shprehet me rezultate të matshme e të kontrollueshme me indikatorë sasiore e cilësorë, që mund të arrihen me aktivitete brenda mundësive të financimit. Çdo objektiv mund të ketë një ose disa rezultate. Mundet që një rezultat të mbështesë më shumë se një objektiv.
- Pasqyrohen aktivitetet që do të kryhen për të arritur rezultatet e kërkuara (sipas formatit të dhënë). Çdo rezultat duhet të mbështetet të paktën nga një aktivitet. Për çdo aktivitet përcaktohet kohëzgjatja (muaj, javë, etj).
- Paraqitet ndarja e fondeve (shpenzimeve) sipas zërit të veçantë në tabelën e formatit të buxhetit (shiko *Aneks 2*), ku çmimi për njësi të përfshijë të gjithë koston e blerjes së pajisjes.

**LISTA E DOKUMENTAVE TË PARAQITURA BASHKË ME PROJEKT  
PROPOZIMIN**

- Shkresë shoqëruese e dosjes së aplikimit firmosur nga titullari i IAL –së.
- Formati i projekt propozimit i plotësuar sipas udhëzuesit.  
Projekt propozimin i hartuar dhe paraqitur vetëm sipas formularit standard të aplikimit Aneksi 1 “Formati i aplikimit” <http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare2/>).
- Buxheti i projekt propozimit Aneksi 2 “Forma e propozimit financiar”
- Vetëdeklarim i Drejtuesit të projektit që janë shlyer të gjitha detyrimet pranë AKKSHI nëse ka qenë më parë përfitues i fondeve të AKKSHI-së;
- Miratimin e titullarit të Institucionit Publik i Arsimit të Lartë për pjesëmarrje në projekt;
- Një analizë tregu të bërë për çmimet e paisjeve në kuadër të ngritjes së laboratorit të kërkuar.
- CV e Drejtuesit të projektit, i cili duhet të ketë të paktën gradën “Doktor” në fushën përkatëse;
- Vendimin e akreditimit të Institucionit Publik i Arsimit të Lartë që aplikon;
- Në rastet kur për projekt-propozimin është siguruar bashkëfinancim (IAL, IAL partnere, biznesi, donatorët etj), IAL aplikuese duhet të sjellë një evidencë lidhur me bashkëfinancimin (psh një marrëveshje bashkëpunimi midis IAL dhe biznesit).